



Pranuar / Dorezuar Prijmljena / Prodato Received / Delivery	07-05-2021	1	viti god year
Organ./Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTHCX	2286	2021	1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.143/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti - kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani- anëtar, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit kanë shqyrtuar ankesën A.nr.143/2021, të datës 16.03.2021, së ankuesit me adrese banimi rruga „Vëllezërit Gërvalla, nr. 23 nga Komuna e Fushë Kosovës, kundër organit të punësimit Këshilli Prokurorial i Kosovës, në çështjen juridike “pezullim parandalues”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 07.05.2021, mori këtë;

V E N D I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.143/2021 e datës 16.03.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. SHFUQIZOHET, Vendimi KD: Nr.04/2020 i datës 23/10/2020, i Komisionit Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

III. MBETET NË FUQI, Vendimi Nr. Prot. DPSKPK/ Nr.236/2020, Nr.1069 i datës 29.10.2020, i Drejtorit të përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për pezullim parandalues për ankuesin

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.02.2021 A.nr.437/2020, ka nxjerr vendim me të cilin ka detyruar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, të Këshillit Prokurorial të Kosovës, që në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh që të bëjë rishqyrtimin e ankesës së datës 10.11.2020, të ankuesit

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Këshillit Prokurorial të Kosovës, me qellim të zbatimit të vendimit të Këshillit, më datë 01.03.2021, me numër KA.Nr.02/2021, ka nxjerr vendim me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit, duke e lenë në fuqi vendimin Nr.Prot.DPSKPK/Nr.236/2020, 1069/2020 i datës 29.10.2020 të i Drejtorit të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për pezullim parandalues për ankuesin

Ankuesi i pakënaqur me vendimin KA.Nr.02/2021 të datës 01.03.2021, me numër protokollit 306/2021, dhe datë të protokollit 02/03/2021, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve të Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me datën 16.03.2021, me numër protokollit 1176/2021 me ankesë i është drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër Vendimit KA.Nr.02/2021 të datës 01.03.2021, me numër protokollit 306/2021, dhe datë të protokollit 02/03/2021, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve të Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.04.2021, me numër protokollit V.k.Nr. 22/2021, ka nxjerr vendim për zgjatjen e afatit për vendosjen e ankesës edhe për dhjetë ditë pune (10), tjera, pas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit për Shqyrtimin e ankesës.

Kolegji me rastin e vendosjes në lidhje me këtë lëndë ka administruar provat si në vijim:
Ankesën A.nr. 143/2021 e parashtruar më datë 16.03.2021 me numër protokollit 1176/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 30.04.2021, për shtyrjen e afatit, i Kryetarit të KPMSHCK-së, për ankuesin e- maili i datës 20.04.2021, i Zyrtarit Ligjor të Prokurorisë Themelore në Prishtinë; kërkesa e datës 15.04.2021, me numër protokollit 1806/2021, drejtuar Prokurorisë Themelore në Prishtinë; Vërtetim i datës 16.03.2021; kërkesë e datës 18.03.2021, për plotësimin ankesës drejtuar Këshillit; Ankesë e datës 16.03.2021, me numër protokollit 1176/2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 01.03.2021, me numër protokollit KA. Nr. 02/2021, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi i datës 26.01.2021, me numër A.nr.437/2020, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës pre Shërbimin Civil të Kosovës; vendimi i datës 08.02.2021, i KPMSHCK-së për zgjatjen e afatit të ankesës kërkesë e datës 08.02.2021, për zgjatjen e afatit për shtyrjen e ankesës së ankuesit Ankesa e datës 28.12.2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës pre Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 03.12.2020, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesa e datës 05.11.2020, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi i datës 28.10.2020, për pezullim parandalues; Vendimi i datës 14.02.2020, për pezullim parandalues; Aktvendimi i datës 07.09.2020, i Gjykatës Themelore në Pejë/Departamenti për Krime të Rënda; Vendimi i datës 29.10.2020, për shfuqizimin e vendimit të datës 14.02.2020, për pezullim parandalues për ankuesin Vendimi i datës 23.10.2020, me numër protokollit KD.Nr. 04/2020, i Komisionit Disiplinor; kërkesë e datës 11.09.2020, për Kthimin në punë; vendimi i datës 20.11.2019, i Inspektoratit të Punësimit; vendimi i datës 04.09.2019, i Komisionit Disiplinor; Vendimi i datës 03.12.2020, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesa e datës 10.11.2020, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesa e datës 21.04.2020 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës

për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 15.06.2020,i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesa e datës 10.03.2020 drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Përgjigje në ankesë e datës 14.01.2021,me numër protokolli 136/2021, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me qëllim të vendosjes meritore, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës,provat që kanë qenë edhe në ankesën e kaluar si dhe provat që janë dorëzuar me ankesën e datës 16/03/2021, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pjesërisht e bazuar SEPSE:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave shqyrtoi pretendimet ankimore të ankuesit idhur me marrjen e vendimit për pezullim parandalues nga ana Drejtorit të përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për pezullim parandalues. Kolegji për shqyrtimin e dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë të bazuara dhe në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se Drejtori i përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, më vendimin Nr.Prot.DPSKPK/Nr.236/2020,Nr.1069 i datës 29.10.2020 ka pezulluar nga puna ankuesin deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e Gjykatës, dhe veprimi i ndërmarrë ka qenë në pajtim me nenin 69 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe paragrafin 2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku thuhet shprehimisht se;1. Nëpunësit civilë pezullohen, me pagesë 50% të rrogës se tij/saj, menjëherë nga detyra nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit të institucionit punëdhënës nëse: 1.1.kundër tij/saj është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij/saj; 2. Në rast të pezullimit parandalues, nëpunësi civil do të marrë 50% të rrogës së tij/saj gjatë tërë kohëzgjatjes së pezullimit, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata. Ndërsa ky veprim sipas këtij vendimi është i bazuar në aktvendimin e prokurorit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, i cili ka nxjerr aktvendim PP/I.nr.162/20 me datë 28.10.2020,për fillimin e Hetimeve,i dyshuar për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit Zyrtar sipas nenit 414 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj mbi këtë bazë kolegji konsideron se pretendimi ankimor është i pabazuar sa i përket kësaj çështje.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës së plotësuar më datë 18/03/2021,bazuar në pretendimin e tij sa i përket vendimit për masën disiplinore sipas vendimit të poshtëshënuar ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes vendimit KD:Nr.04/2020 të datës 23.10.2020,ka nxjerr vendim me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore, Largim nga Zyra dhe Transferim në pozitën „ receptionist“, po të njëjtën Prokurori dhe ndalim i gradimit për tri (3) vite, veprim ky i cili është në kundërshtim me nenin 68 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku thuhet shprehimisht se; Asnjë masë disiplinore nuk mund të aplikohet për kryerjen e një vepre, e cila dënohet sipas ligjit penal para marrjes së një vendimi në shkallën e parë. Sepse në rastin konkret ankuesi veç ka qenë i pezulluar sipas vendimit Nr.Prot.DPSKPK/56/2020 të datës 14/02/2020 deri



më datë 29/10/2020 ku përmes vendimit Nr.Prot.DPSKPK/Nr.235/2020,Nr.1068 i datës 29.10.2020 është shfuqizuar vendimi i potencuar më lartë mbi pezullimin parandalues me arsye se kanë pushuar hetimet nga prokuroria.

Andaj nga konstatimi i nxjerrë në lidhje me këtë çështje vërtetohet fakti se masa disiplinore e shqiptuar përmes vendimit KD:Nr.04/2020 të datës 23/10/2020 është në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës respektivisht nenin 68 të këtij ligji, andaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor është i bazuar.

Andaj nga deklaratimet e mësipërme mund të konstatohet se Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës me rastin e nxjerrjes së vendimit KD:Nr.04/2020 të datës 23/10/2020 nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat e të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr.04/2011 për Procedurat disiplinore në shërbimin civil, sepse nuk ka konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike dhe mbi këto arsye ankesa është aprovuar pjesërisht si e bazuar.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: **"Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës"**, dhe me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të po këtij ligji është përcaktuar se: **"Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit"**.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda, A.nr.143/2021, datë 07/05/2021



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Rushit Kajtazi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm në Këshillin Prokurorial të Kosovës
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Këshillin Prokurorial të Kosovës
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së

